


INDEKSI

I TRANSPARENCËS PROAKTIVE TË INSTITUCIONEVE QENDRORE DHE TË VARËSISË

DHJETOR 2021



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Indeksi i Transparencës

Raport Monitorimi

Transparenca Proaktive i Institucioneve Qendrore dhe të Varësisë

Dhjetor 2021

Monitorimi u krye nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Raporti u hartua nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Përmbajtja

Hyrje	4
Metodologjia.....	6
Monitorimi i Autoriteteve Publike.....	9
Këshilli i Ministrave	9
Institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave	10
Institucionet e pavarura.....	15
Sistemi i Drejtësisë (Përfshirë gjykata, prokurori dhe institucionet e reja të sistemit të drejtësisë)	16
Autoritete të tjera (Institucione të Arsimit të Lartë/ Shoqëri tregtare ku shteti zotëron shumicën e aksioneve)	19
Gjetjet përfundimtare të Indeksit i Transparencës Proaktive të Institucioneve Qendrore dhe të Varësisë .	20

Hyrje

E drejta për informim është e drejta e qytetarëve për të patur akses në dokumente zyrtare, si dhe detyrimi i autoriteteve publike për të përmbushur këtë të drejtë pa kërkuar motivet. E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila pas miratimit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” ka sjell një garanci më të madhe ligjore për aksesin e qytetarëve në informacion dhe kushtet e duhura të transparencës proaktive për të ushtruar të drejtat e tyre.

Një nga risitë e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” është zbatimi i programeve të transparencës sipas modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Nëpërmjet Programit të Transparencës i cili publikohet në faqen zyrtare, autoritetet publike vendosin në dispozicion të qytetarëve një kategori të gjerë informacionesh.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar nëpërmjet Urdhrit nr. 187 datë 18.12.2020 “Programin e Transparencës të Rishikuar” i cili është i detyrueshëm për të gjitha autoritetet¹ publike sipas përcaktimit të bërë në nenin 2 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.



Një nga fazat e rëndësishme në sigurimin e transparencës në nivel qendror është edhe monitorimi i zbatimit të Programit të Transparencës. Monitorimi lejon të vlerësohet niveli i transparencës tek

¹ Me përjashtim të njërive të vetëqeverisjes vendore për të cilët është i detyrueshëm Programi Model i Transparencës sipas Urdhrit nr. 211, datë 10.09.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

autoritetet publike. Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbikëqyr respektimin e dispozitave të ligjit për të drejtën e informimit dhe në rastet kur vëren mosrespektimin e tyre, bën vlerësimin e kundravajtjes dhe vendos masa administrative.

Transparenca proaktive nëpërmjet publikimit të informacioneve në Programin e Transparencës, kërkon një impenjim të institucioneve publike për ta përditësuar dhe plotësuar me informacion në mënyrë të vazhdueshme. Për këtë arsye, monitorimi i transparencës të autoriteteve publike kryhet në bazë vjetore, duke lehtësuar kështu kryerjen e analizave krahasimore në të ardhmen.

Gjatë vitit 2021, Zyra e Komisionerit ka monitoruar sërish zbatimin e Programit Model të Transparencës, duke u bazuar në metodologjinë e përdorur për herë të parë gjatë Indeksit të Transparencës së Autoriteteve Qendrore dhe të Varësisë në vitin 2020, e cila lejon krahasimin midis autoriteteve publike, si dhe evidenton në mënyrë të qartë dhe saktë mangësitë në ato autoritete të cilat nuk i kanë përmbushur detyrimet ligjore që burojnë nga ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Gjetjet e këtij monitorimi dhe indeksi synojnë jo vetëm të nxisin ndërgjegjësimin për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, si dhe rritjen e nivelit të transparencës përmes publikimit proaktiv të informacionit, por të shërbejnë dhe si një referencë përpara vendimmarrjes së Zyrës së Komisionerit në respektim të dispozitave ligjore.

Metodologjia

Sistemi i matjes i përdorur në këtë monitorim i referohet 5 treguesve kryesorë të cilët bëjnë vlerësimin objektiv të nivelit funksional të transparencës proaktive të autoriteteve publike qendrore dhe të varësisë. Numri total i pikëve të vlerësimit të treguesve është 5 (pesë). Bazuar në pikëzimin e çdo treguesi, llogaritet shuma totale e vlerësimit për secilin institucion.

Instrumentet kryesore për matjen e transparencës proaktive janë: publikimi i Programit Model të Transparencës së rishikuar në faqen zyrtare të autoriteteve publike sipas Urdhrit nr. 187, dt. 18/12/2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të rishikuar” dhe publikimi i Regjistrimit të Kërkesave dhe Përgjigjeve të rishikuar” sipas Urdhrit nr. 188, datë 18.12.2020 “Për miratimin e Regjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuar”.

Kërkimi në internet është përdorur për të vlerësuar treguesit duke vlerësuar gjendjen reale në momentin e kërkimit.

Treguesi i parë:

Publikimi i Programit Model të Transparencës për Autoritetet Publike sipas urdhrimit nr. 187, datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të rishikuar”.

Pikët:

Vlerësimi: 0-informacioni nuk është publikuar
0,5-informacioni është publikuar pjesërisht
1-informacioni është i publikuar

Treguesi i dytë:

Publikimi i Regjistrimit të Kërkesave dhe Përgjigjeve i përditësuar gjatë vitit 2021, sipas urdhrimit nr. 188, datë 18.12.2020 “Për miratimin e Regjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuar”

Pikët:

Vlerësimi: 0-informacioni nuk është publikuar
0,5-informacioni është publikuar pjesërisht
1-informacioni është i publikuar

Treguesi i tretë:

Të dhënat e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit

Pikët:

Vlerësimi: 0 - informacioni nuk është publikuar
0,5- informacioni është publikuar pjesërisht
1-informacioni është i publikuar

Treguesi i katërt:

Publikimi i informacionit mbi “Të dhënat e Koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Pikët:

Vlerësimi: 0-informacioni nuk është publikuar

0,5-informacioni është publikuar pjesërisht

1-informacioni është i publikuar

Në këtë rubrikë institucionet që nuk hartojnë akte ligjore/nënligjore, politika publike, pra nuk kanë iniciativë ligjore, nuk prodhojnë informacion lidhur me këtë tregues janë vlerësuar me 1 pikë me yll (1*).

Treguesi i pestë:

Publikimi i të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar 2021.

Pikët:

Vlerësimi: 0-informacioni nuk është publikuar

0,5-informacioni është publikuar pjesërisht

1-informacioni është i publikuar

Ky sistem matje i transparencës proaktive i referohet dhe është i ngjashëm me sistemin e matjes së transparencës së autoriteteve publike qendrore dhe të varësisë për vitin 2020 i cili është i publikuar në faqen zyrtare të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në linkun e mëposhtëm:

https://www.idp.al/wp-content/uploads/2021/01/raport_monitorimi_i_institucioneve_qendrore_dhe_te_varesise.pdf

Në raportin e vitit 2021, Zyra e Komisionerit është përpjekur të sjellë një panoramë më të gjerë të nivelit të transparencës së autoriteteve publike qendrore dhe të varësisë duke përfshirë në indeks 100 autoritete publike përkundrejt 36 autoriteteve publike që u analizuan në vitin 2020.

Në listën e autoriteteve publike pjesë e indeksit të transparencës bëjnë pjesë Kryeministria, Ministrinë, institucionet e varësisë, institucionet të pavarura, institucionet e reja të sistemit të drejtësisë, gjykatat, prokuroritë, institucionet e arsimit të lartë si dhe shoqëri aksionere ku shteti zotëron shumicën e aksioneve.

Një tjetër risi e indeksit të transparencës së autoriteteve publike dhe të varësisë ka të bëjë me sistemin e matjes së treguesve. Për të sjellë një analizë më cilësore të të dhënave, matja e treguesve është kryer me 3 nivele: 0 pikë në rast se informacioni nuk është publikuar; 0,5 pikë kur informacioni është publikuar pjesërisht dhe 1 pikë kur informacioni është i publikuar plotësisht. Ndërkohë që minimumi dhe maksimumi i pikëve është mbajtur i njëjtë me sistemin e matjes së

transparencës së autoriteteve publike qendore dhe të varësisë të vitit 2020 (nga 0 në 5) për të pasur të njëjtën bazë krahasuese.


Ky sistem matje i transparencës proaktive ngjan me një sistem semafor.

Autoritetet Publike që i kanë të gjithë treguesit negativ dhe për këtë arsye kanë grumbulluar 0 pikë, kanë një transparencë proaktive të pamjaftueshme dhe në semafor shënohen me dritë të kuqe.

Autoritetet Publike që kanë grumbulluar 1 – 2 pikë kanë një transparencë proaktive të ulët dhe në semafor janë shënuar me dritë të verdhë.

Autoritetet Publike që kanë grumbulluar 2.5 - 4 pikë kanë një transparencë proaktive të mesme dhe në semafor janë shënuar me dritë të bardhë.

Autoritetet Publike të cilat i kanë të gjithë treguesit pozitiv dhe kanë grumbulluar 4.5 - 5 pikë kanë një transparencë proaktive të lartë dhe në semafor janë shënuar me dritë të gjelbër.



Semafor i Kuq = 0 - 0.5 pikë

Semafor i Verdhë = 1 - 2 pikë

Semafor i Bardhë = 2.5 - 4 pikë

Semafor i Gjelbër = 4.5- 5 pikë

Monitorimi i Autoriteteve Publike

Monitorimi i i zbatimit të Programit të Transparencës sipas indikatorëve të përmendur në këtë metodologji është kryer gjatë periudhës shtator – dhjetor 2021 dhe është ndarë në 5 kategori kryesore “Këshilli i Ministrave”, “Institucionet e varësisë” “Institucionet e pavarura” “Sistemi i Drejtësisë” dhe Autoritete të tjera (përfshirë universitetite dhe shoqëri tregtare ku shteti zotëron shumicën e aksioneve). Për çdo kategori institucionesh është zgjedhur një numër i kufizuar autoritësh nga secila kategori me përjashtim të autoriteteve publike që përbëjnë “Këshillin e Ministrave” të cilët janë paraqitur të gjithë në këtë indeks. Kategoria më e populluar është kategoria e institucioneve të varësisë.

Për çdo kategori autoritësh publike, institucionet janë radhitur sipas pikëve të grumbulluara.

Këshilli i Ministrave

Nr.	Autoriteti Publik	Programi Transparencës i rishikuar	Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve i rishikuar	Koordinatori	Konsultimi Publik	Buxheti 2021	Totali
1	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1	1	1	1	1	5
2	Kryeministria	1	1	1	1	0.5	4.5
3	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	1	0.5	1	1	1	4.5
4	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1	1	1	1	0.5	4.5
5	Ministria e Mbrojtjes	1	1	1	1	0	4
6	Ministria e Drejtësisë	1	1	1	1	0	4
7	Ministria e Kulturës	1	1	1	1	0	4

8	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	1	1	1	0	1	4
9	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	1	1	1	0	0	3
10	Ministria e Brendshme	1	0	1	0	0	2
11	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	1	0	1	0	0	2
12	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	1	0	0	0	1	2

Institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave

Nr .	Autoriteti Publik	Programi Transparencës i rishikuar	Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve i rishikuar	Koordinatori	Konsulti mi Publik	Buxheti i 2021	Totali
1	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës	1	1	1	1	1	5
2	Agjencia Kombëtare e Mjedisit	1	1	1	1	1	5
3	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve të Integruara	1	1	1	1	0.5	4.5

4	Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor	1	1	1	1	0.5	4.5
5	Departamenti i Administratës Publike	1	0.5	1	1	0.5	4
6	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	1	1	1	0	1	4
7	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	1	1	1	0	1	4
8	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	1	1	1	0	1	4
9	Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore	1	1	1	0	1	4
10	Agjencia Kombëtare e zonave të Mbrojtura	1	1	1	1	0	4
11	Agjencia Kombëtare e Bregdetit	1	1	1	0	1	4
12	Avokatura e Shtetit	1	0.5	1	0	1	3.5
13	Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit	1	0.5	1	0	1	3.5
14	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm i Kujdesit Shëndetësor	1	0,5	1	0	1	3.5
15	Agjencia e Aviacionit Civil	1	0,5	1	1	0	3,5
16	ASCAL – Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë	0,5	1	1	1	0	3,5

17	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile	1	0	1	0	0	3
18	Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare	1	0.5	1	0	0.5	3
19	Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit	1	0.5	1	0	0.5	3
20	Autoriteti i Mbikqyrjes së Lojërave të Fatit	1	1	1	0	0	3
21	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	1	1	1	0	0	3
22	Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar	1	0,5	1	0	0,5	3
23	Qendra e Shërbimeve Arsimore	1	0,5	1	0	0,5	3
24	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas	1	1	1	0	0	3
25	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë	1	0,5	1	0	0,5	3
26	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural	1	1	1	0	0	3
27	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore	1	1	1	0	0	3

28	Shërbimi Social Shtetëror	1	0.5	1	0	0.5	3
29	Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor	1	1	1	0	0	3
30	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve	1	0	1	0	1	3
31	Autoriteti Rrugor Shqiptar	1	0,5	1	0	0	2,5
32	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit	1	0,5	1	0	0	2,5
33	Agjencia e Trajtimit të Pronave	1	0,5	1	0	0	2,5
34	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	1	0,5	1	0	0	2,5
35	Autoriteti i Kontrollit Shtetëror i Eksporteve (AKSHE)	1	1	0.5	0	0	2.5
36	Agjencia e Administrimit të Pasurive dhe Aseteve të Sekuestruara dhe Konfiskuara	1	0	1	0	0.5	2.5
37	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	1	0.5	1	0	0	2.5

38	Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambli Popullor	1	0,5	1	0	0	2.5
39	Agjencia Kombëtare e Turizmit	1	1	0.5	0	0	2.5
40	Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve	1	0	1	0	0	2
41	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit	1	0	1	0	0	2
42	Drejtoria e shërbimit diplomatik	1	0	0	0	1	1

Institucionet e pavarura

Nr.	Autoriteti Publik	Programi Transparencës i rishikuar	Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve i rishikuar	Koordinatori për të drejtën e informimit	Konsultimi Publik	Buxheti 2021	Totali
1	Agjencia e Sigurimit te Depozitave (ASD)	1	1	1	1	1	5
2	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)	1	1	1	1	1	5
3	Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)	1	1	1	1	1	5
4	Instituti i Statistikave INSTAT	1	1	1	1	1	5
5	Autoriteti i Konkurrencës	1	1	1	1	0.5	4.5
6	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)	1	1	1	0	1	4
7	Enti Rregullator i Energjisë	1	0.5	1	1	0.5	4
8	Enti Rregullator i Ujit	1	0.5	1	1	0.5	4
9	Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit	1	1	1	0	0.5	3.5

10	Komisioni i Prokurimit Publik	1	1	1	0	0	3
----	-------------------------------	---	---	---	---	---	---

Sistemi i Drejtësisë (Përfshirë gjykata, prokurori dhe institucionet e reja të sistemit të drejtësisë)

Shënim: Për efekt të metodologjisë në kategorinë e institucioneve të sistemit të drejtësisë janë vlerësuar me 1* të gjitha institucionet e drejtësisë për indikatorin konsultim publik .

Nr.	Autoriteti Publik	Programi Transparencës i rishikuar	Regjistri	Koordinatori	Konsultimi publik	Buxheti	Totali
1	Gjykata Kushtetuese	1	1	1	1*	0	5*
2	Gjykata Administrative e shkallës së parë Korçë	1	1	1	1*	1	5*
3	Gjykata Administrative e shkallës së parë Shkodër	1	1	1	1*	1	5*
4	Kolegji i Posaçëm i Apelit	1	1	1	1*	1	5*
5	Institucioni i Komisionerit Publik	1	1	1	1*	1	5*
6	Gjykata e Lartë	1	1	0,5	1*	1	4.5*
7	Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë	1	0,5	1	1	1	4.5*

8	Gjykata Administrative e shkallës së Parë Tiranë	1	1	1	1*	0	4*
9	Prokuroria e Përgjithshme	1	0	1	1*	1	4*
10	Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (S PAK)	1	0.5	1	1*	0.5	4*
11	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Dibër	1	0.5	1	1*	0.5	4*
12	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan	1	0.5	1	1*	0.5	4*
13	Këshilli i Lartë Gjyqësor	1	1	1	1*	0	4*
14	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	1	0.5	1	1*	0.5	4*
15	Gjykata Administrative e shkallës së parë Durrës	1	1	0,5	1*	0	3.5*
16	Gjykata e Rrethit Berat	1	1	0.5	1*	0	3.5*
17	Gjykata e Rrethit Gjirokaster	1	1	0,5	1*	0	3.5*
18	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier	1	0.5	1	1*	0	3.5*

19	Këshilli i Lartë i Prokurorisë	1	0.5	1	1*	0	3.5*
20	Gjykata Administrative e shkallës së parë Gjirokastrë	1	1	0	1*	0	3*
21	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat	1	0	1	1*	0	3*
22	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës	1	0	1	1*	0	3*
23	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë	1	0	1	1*	0	3*
24	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë	1	0	0.5	1*	0	2.5*
25	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë	1	0	0.5	1*	0	2.5*
26	Gjykata Administrative e Apelit	1	0.5	0	1*	0	2.5*

Autoritete të tjera (Institucione të Arsimit të Lartë/ Shoqëri tregtare ku shteti zotëron shumicën e aksioneve)


Nr.	Autoriteti Publik	Programi Transparencës i rishikuar	Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve i rishikuar	Koordinatori për të drejtën e informimit	Konsultimi Publik	Buxheti 2021	Totali
1	Universiteti “Eqerem Çabej”	1	0.5	1	1	0.5	4
2	Universiteti i Tiranës	1	0.5	1	1	0.5	4
3	OST sh.a Tiranë	1	0.5	1	0	0.5	3
4	Universiteti “Aleksandër Moisiu”	1	0.5	1	0	0	2.5
5	Universiteti Bujqësor i Tiranës	1	0.5	1	0	0	2.5
6	Albpetrol sh.a. Fier	1	0.5	1	0	0	2.5
7	Universiteti “Aleksandër Xhuvani”	1	0	1	0	0	2
8	Hekurudha Shqiptare, sh.a	1	0	1	0	0	2
9	Posta Shqiptare sh.a	1	0.5	0.5	0	0	2
10	OSHEE	1	0	0.5	0	0	1.5

Gjetjet përfundimtare të Indeksit i Transparencës Proaktive të Institucioneve Qendrore dhe të Varësisë

Institucionet qendrore dhe ato të varësisë janë renditur në Indeksin e Transparencës Proaktive sipas rezultateve të monitorimit bazuar në metodologjinë e semaforit, duke vendosur në fillim të listës autoritetet publike të cilat kanë grumbulluar numrin më të lartë të pikëve dhe duke vazhduar në rend zbritës, sipas grupimeve përkatëse. Renditja e autoriteteve publike brenda të njëjtit grupim me të njëjtin numër pikësh është e rastësishme.

Në përfundim të monitorimit të transparencës proaktive vërejmë se autoritetet publike qendrore dhe të varësisë kanë një qëndrueshmëri të transparencës proaktive në indikatorët e “Publikimi i Programit të Rishikuar të Transparencës” dhe “Publikimi i të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit”.

Për sa i përket tre indikatorëve të tjerë “Përditësimi i regjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve për vitin 2021”, “Publikimi i informacionit mbi koordinatorin për njoftim dhe konsultim publik” dhe “Publikimi i të dhënave për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar 2021”, vihet re se ka një performance më të ulët të transparencës.



Semafor i Kuq = **0** Autoritete Publike

Semafor i Verdhë = **10** Autoritete Publike

Semafor i Bardhë = **70** Autoritete Publike

Semafor i Gjelbër = **20** Autoritete Publike

Rezultatet e këtij monitorimi tregojnë se të gjitha autoritete publike qendrore dhe të varësisë të shqyrtuar në këta raport, kanë publikuar *Programin Model të Transparencës së Rishikuar në faqen zyrtare të autoriteteve publike sipas Urdhrit nr. 187, dt. 18/12/2020 “Për miratimin e Programit*

të Transparencës të rishikuar”, i cili është i detyrueshëm për t’u zbatuar nga autoritetet publike, duke përjashtuar njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Në të njëjtin trend është edhe indikator i “Publikimit të të dhënave të koordinorit për të drejtën e Informimit”, ku 94 autoritete publike përkundrej 100 Autoritete publike (94%) të monitoruara, e kanë publikuar informacionin përkatës plotësisht ose pjesërisht.

Në lidhje me regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, monitorimi evidenton me pikë pozitive vetëm ato raste kur regjistri është përditësuar gjatë vitit 2021. Numri total i autoriteteve publike qendrore dhe të varësisë, të cilët kanë përditësuar regjistrin e kërkesave plotësisht ose pjesërisht është 81, përkundrej 100 autoritete publike të monitoruara, çka përbën 81 % të autoriteteve publike që kanë zbatuar detyrimin ligjor për përditësimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve.


Nga ana e autoriteteve publike qendrore dhe të varësisë, janë konstatuar mangësi më të theksuara në publikimin e informacionit proaktiv i cili ka të bëjë me “Publikimi i të dhënave për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar 2021, ku kanë publikuar pjesërisht ose plotësisht buxhetin e vitit 2021, vetëm 57 autoritete publike, përkundrej 100 të monitoruara (57%).

Ndërkohë gjatë vitit 2021 është monitoruar edhe detyrimi për përcaktimin e një koordinorit për njoftimin dhe konsultimin publik i cili duhet të jetë i publikuar edhe në programin e transparencës. Për qëllimin e këtij raporti institucionet e drejtesisë (26 në total) janë shënuar me 1* në indikatorin e vlerësimit duke mos e konsideruar në llogaritjen përfundimtare . Nga 74 autoritetet e tjera publike rezulton se 23 (31%) prej tyre kanë publikuar të dhënat e koordinorit për njoftimin publik plotësisht ose pjesërisht ndërsa autoritetet e tjera ose nuk e kanë publikuar ose e vetëpërfshojnë autoritetin publik nga detyrimet e ligjit nr.146/2015 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”

Në krahasim me monitorimin e kryer në vitin 2020, rezulton se gjatë vitit 2021, Autoritetet Publike Qendrore dhe të Varësisë kanë një performancë më të mirë në publikimin e informacionit proaktiv në faqet e tyre zyrtare të internetit nëpërmjet të cilit është kryer dhe ky monitorim.

Siç vihet re edhe nga grafiku i mëposhtëm, krahasimi i vlerave në % i monitorimi të publikimit të programit të transparencës sipas modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, publikimi i të dhënave të koordinorëve për të drejtën e informimit, përditësimi i regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve si dhe publikimi i informacionit mbi buxhetin institucional për vitin 2021 është në nivele më të larta se gjatë vitit 2020.

Tab. 1 Rezultat e monitorimit te zbatimit te Programit te Transparences ne vitin 2021 dhe vitin 2020.



Gjetjet e këtij monitorimi dhe indeksi synojnë jo vetëm të nxisin ndërgjegjësimin për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, si dhe rritjen e nivelit të transparencës përmes publikimit proaktiv të informacionit, por të shërbejnë dhe si një referencë përpara vendimmarrjes së Zyrës së Komisionerit në respektim të dispozitave ligjore.